



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-60924

Me date: 20.09.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.-03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr-2008/28 ,Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë:

**AUTORIZIM**

Autorizohet **Z. Fatos Kuqi** - shef i prokurimit që të përfaqësoj Ak Komuna e Suharekës me datë 20.09.2022 në ora 10:00 pranë zyrave të OSHP që do të mbahet seanca për shqyrtimin kryesor të kërkesës nga AK "KK Suharekë" për diskualifikim të OE "Lirim Kicaj B.I" – Greikoc me nr.160/22.

Ky autorizim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlenë deri në përfundimin e kësaj procedure.



Të njoftohen:

-Punëtorit

-Arkiva



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-57856

Me date: 05.09.2022

Duke u bazuar ne nenin 13, 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, ( Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), Nenit 52, 1.1 mbi transferin e përkohshëm të Ligjit për Zyrtarë Publik numër 06/L-114, Neni 4, 5 dhe Neni 9 i Rregullorës Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil Kryetari i Komunës nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

Transfer i përkohshëm

- I. Z. Fatos KUÇI, transferohet përkohësisht në pozitën Shef i Zyrës së Prokurimit të Komunës së Suharekës nga data 05.09.2022 deri 04.03.2023, Koeficienti 9
- II. Për zbatim të këtij Vendimi kujdeset Zyra e Personelit, Komuna Suharekë
- III. Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës

**Arsyetim**

Zyra e Kryetarit me date 01.09.2022 ka pranuar Njoftimin 01-016-57349 nga Shef I Zyrës së Prokurimit, z. Bujar Kuçi ku njofton se nga data 05.09.2022 do të jem në shfrytëzim të pushimit vjetor të mbetur për vitin 2022 dhe se nga data 14.09.2022 nuk do të jem më pjesë e stafit të Komunës në detyrën e Shefit të Prokurimit pasi, pas një procesi të rekrutimit për projektin KMI/USAID-DAI kam pranuar konfirmimin se jam pranuar në këtë projekt si këshilltar për prokurim në Komuna.

Andaj duke u marrë parasysh këtë fakt Kryetari i Komunës vendosi që i lartpërmenduri të transferohet përkohësisht në detyrat e punës në pozitën e Shef i Zyrës së Prokurimit të Komunës së Suharekës nga data 05.09.2022 deri 04.03.2023.

Nëpunësi i lartpërmendur ka përgaditjen e duhur profesionale, Licensen nga KRPP si dhe përvojën e aftësin për kryerjen e detyrave të punës të shefit të zyrës së prokurimit .

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Dërgohet:  
Zyra e Personelit, Punëtorit, Arkiva

Bali MEHARREMAJ

Kryetari i Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA  
 REPUBLIC OF KOSOVA  
 KOMUNA E SUHAREKËS  
 OPSTINE SUVA REKA  
 THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



**DEKRETI I KRYETARIT TË KOMUNËS**

*010-63051*

**datë: 29.09.2022**

bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040, nenit 44 të Ligjit për Punë të Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 3336 të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Arsim me numër të protokollit 01-104-61791-2 të datës 23.09.2022, për lejimin e projektit “Ndërtim të çerdhës së fëmijëve” në fshatin Bukosh-Komuna Suharekë.

Për zbatimin e këtij aktvendimi kujdeset Drejtoria për Arsim

Ky aktvendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Suharekës.

**Arsyetim**

Dhjetë e kërkesave të komunitetit të fshatit Bukosh dhe fshatrave rreth tij me datë 23.09.22, është bërë kërkesa e Drejtorisë Komunale të Arsimit për të ndërtuar një çerdhe të fëmijëve në fshatin Bukosh e cila do të jetë paralele e IP “Fluturat” në Suharekë, në mënyrë që fëmijët e moshave 3 deri në 5 vjeç, të vijnë nën kujdesin e hershëm në një institucion më afër vendbanimeve të fëmijëve. Pas shqyrtimit të kërkesës, Zyra e Kryetarit aprovon kërkesën tuaj për lejimin e projektit “Ndërtim të çerdhës së fëmijëve” në fshatin Bukosh-Komuna Suharekë.

Siç u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Emri: **Emzi Bajselmani-Drejtor i DKA-së në Suharekë**

*Hyeti*





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-62738

Me datë: 28.09.2022

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. **Enver Shabani, Drejtor në Drejtorinë për Shërbime publike, Mjedis dhe Emergjenc,** caktohet përgjegjës për kursim të energjisë, që çdo ditë pas përfundimit të orarit të punës të plotësoj formularin përmes të cilit tregon kontrollin rreth zbatimit të masave për kursimin e energjisë dhe të njëjtin të ja dorëzoj Udhëheqësit të Departamentit/Njësisë përkatëse për Administratë.
- II. Personi përgjegjës i caktuar sipas pikës 14 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 28/96 të datës 14.09.2022 në lidhje me zbatimin e masave detyruese për kursim të energjisë elektrike në institucionet e nivelit qendror, lokal dhe ndërmarrje publike; si dhe Formularin për mbikëqyrje të masave detyruese për kursim të energjisë, është i obliguar:
  1. Të ndalë të gjitha dritat dhe pajisjet elektrike pas orës 16:00.
  2. Të ndalë të gjithë ndriçimin i cili nuk është i domosdoshëm për siguri fizike të objektit gjatë natës.
  3. Të sigurohet që gjatë orarit të punës prej orës 08:00 deri në 16:00, temperatura për ngohjen e hapsirave të jetë jo më shumë se 19 gradë.
  4. Të sigurohet që pas orës 16:00 deri të nesërmen në ora 07:00 temperatura e ngohjes të zbritet në minimum (kur ngohja bëhet me energji elektrike) në rastet kur është e mundshme.
  5. Të sigurohet që të gjitha dritaret e objektit janë të mbyllura.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Dërgohet: Enver Shabani  
- Arkivi

Bali MUHARREMAJ

Kryetari i Komunës





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 28/96  
Datë: 14.09.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 25 të Ligjit Nr. 05/L -081 për Energjinë, Vendimit të Qeverisë Nr. 21/94 të datës 24.08.2022, Vendimit të Kuvendit Nr.1800/3 të datës 09.08.2022 për miratimin e Vendimit Nr. 01/91 të datës 31.07.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

**Masat detyruese për kursim të energjisë në institucione të nivelit qendror, lokal dhe ndërmarrje publike:**

1. Të zëvendësohen poçat standard në poça LED në të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal si dhe në ndërmarrjet publike;
2. Të ndalet ngrohja në ato zyre apo objekte ku nuk ka prezencë fizike, si dhe në të gjitha korridoret;
3. Të ndalet ngrohja e ujit në objektet e institucioneve publike (ndalimi i përdorimit të bojlerëve), përveç në institucione si spitalet dhe entitetet e ngjashme, ku uji i ngrohtë është i domosdoshëm;
4. Në rastet ku uji i ngrohtë është i domosdoshëm, obligohen institucionet e nivelit qendror dhe lokal, si dhe ndërmarrjet publike të bëjnë mirëmbajtjen dhe pastrimin/ndërrimin e ngrohësve të ujit;
5. Të ndalen pajisjet elektrike (pajisjet e teknologjisë informative, etj.) në rastet kur nuk përdoren për një periudhë më të gjatë se 10 minuta;
6. Të ndalohet përdorimi i klimave (kondicionerëve) përveç në rastet kur nuk ka alternativa tjera për ngrohje;
7. Të ndalohet përdorimi i ngrohësve omik (ngrohësve me energji elektrike);
8. Të mos përdoret ndriçim në hapësira të brendshme dhe zyrat e objekteve publike gjatë periudhës kur ka dritë të mjaftueshme natyrore;
9. Të ndalet çdo billboard apo reklamë që shfrytëzon energjinë elektrike;

10. Të ndalet ndriçimi dekorativ në të gjitha objektet;
11. Aty ku është e mundshme të instalohen sisteme inteligjente për menaxhimin e konsumit të energjisë (si dritat me sensorë, valvulat termostatike, etj);
12. Objektet të cilat ngrohen përmes sistemeve të ngrohjes qendrore të funksionalizojnë potencialin e ngrohjes maksimalisht në dimër duke ndërmarrë hapa të mirëmbajtjes dhe pastrimit të sistemit;
13. Të bëhet sanimi i rrjedhjeve të ujit për zvogëlimin e shpenzimit të energjisë elektrike;
14. Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit të nivelit qendror dhe lokal dhe Zyrtari Kryesor Administrativ i ndërmarrjes publike të caktojë brenda institucionit një person përgjegjës për kursim të energjisë;
15. Personi përgjegjës i caktuar sipas pikës 14 të këtij Vendimi, ka përgjegjësi:
  - 15.1. Të ndalë të gjitha dritat dhe pajisjet elektrike pas orës 16:00;
  - 15.2. Të ndalë të gjithë ndriçimin i cili nuk është i domosdoshëm për siguri fizike të objektit gjatë natës;
  - 15.3. Të sigurohet që gjatë orarit të punës prej orës 08:00 deri në 16:00, temperatura për ngrohjen e hapësirave të jetë jo më shumë se 19 gradë;
  - 15.4. Të sigurohet që pas orës 16:00 deri të nesërmen në ora 07:00 temperatura e ngrohjes të zbritet në minimum (kur ngrohja bëhet me energji elektrike) në rastet kur është e mundshme;
  - 15.5. Të sigurohet që të gjitha dritaret e objektit janë të mbyllura.

#### Masat detyruese për ndriçimin publik


1. Të ndalohet i gjithë ndriçimi publik gjatë periudhës së ditës kur ka dritë të mjaftueshme natyrore.
2. Të ndalohet i gjithë ndriçimi dekorativ në hapësira publike.
3. Të minimizohet (ndalet çdo e treta llambë) ndriçimi publik në autostrada dhe rrugë regjionale deri në masën e domosdoshme për aq sa nuk përbën rrezik për sigurinë e qytetarëve dhe funksionimin normal të komunikacionit.
4. Të ndalet ndriçimi në hapësirat e monumenteve historike, lapidarëve dhe muzeve, për aq sa nuk përbën sigurinë fizike të objektit.

#### Zbatimi

1. Obligohet Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit të nivelit qendror dhe lokal dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes publike në përmbushjen e këtyre masave për kursim të energjisë.
2. Obligohet personi përgjegjës për kursim të energjisë, që çdo ditë pas përfundimit të orarit të punës të plotësoj formularin përmes të cilit tregon kontrollin rreth zbatimit të masave për kursimin e energjisë dhe të njëjtin të ja dorëzoj Udhëheqësit të Departamentit/Njesisë përkatëse për Administratë.

3. Obligohen të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal si dhe ndërmarrjet publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë